

SHENIME SHPJEGUESE; Per periudhen 01 Janar deri me 31 Dhjetor 2021.

Ne kete aneks paraqiten informacionet shpjeguese ne lidhje me pergatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare te njesise ekonomike **BIG MALLAKASTRA sh.p.k.**

Njesia ekonomike **BIG MALLAKASTRA sh.p.k** e krijuar me date 07/01/2020, ushtron aktivitetin e saj ne fushen **BLERJE-SHITJE, IMPORT-EXPORT TE ARTIKUJVE TE NDRYSHEM TE TE GJITHA LLOJEVE ME SHUMICE DHE PAKICE** ne qytetin e Ballshit, Fier.

Per periudhen 01 Janar 2021 deri me 31 Dhjetor 2021 jane pergatitur dhe paraqitur paketa e plote e pasqyrave financiare, te cilat japin pamjen te vertete dhe te drejte te pozicionit financiar, performances financiare dhe fluksit te parase gjate kesaj periudhe.

Pergatitja dhe paraqitja e tyre, e cila eshte pergjegjesi e Drejtimit te subjektit, eshte realizuar mbeshtetur ne Ligjin nr 9228 date 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", ne Standardet Kombetare te Kontabilitetit (SKK) te permiresuara te miratuara nga Keshilli Kombetar i Kontabilitetit(KKK). Gjuha e perdorur eshte gjuha shqipe. Monedha e perdorur eshte monedha Leke. Rrumbullakime te vlerave nuk ka. Ngjarjet dhe trasaksionet jane evidentuar gjate gjithë periudhes ushtrimore ne perputhje me SKK nr 1 Kuadri i pergjithshem per pergatitjen e pasqyrave financiare dhe SKK nr 2 Paraqitja e pasqyrave financiare si dhe cdo standard tjetër kombetar ne perputhje me natyren e ngjarjeve apo trasaksioneve te cilat ne menyre te hollesishme do te jepen ne vijim te informacioneve shpjeguese.

❖ **Shenime shpjeguese ne lidhje me zerat e paraqitur ne pasqyren BILANC.**

Paraqitja e kesaj pasqyre eshte mbeshtur ne paketen e plote te standardeve te permiresuara te miratuara nga Keshilli Kombetar i Kontabilitetit. Ne vijim do te jepen informacionet shpjeguese per zerat perberes te saj.

I. Informacione Shpjeguese per AKTIVET.

Totali i aktiveve te paraqitura ne pasqyren e Bilancit jane ne vleren **32,711,502 leke** detajimi nepermjet informacioneve shpjeguese i te ciles paraqitet si vijon;

✦ **Informacione shpjeguese te AKTIVE AFATSHKURTRA**

Aktiveve afatshkurtra jane paraqitur ne vleren **25,342,533 leke** te cilat jane te perbera nga;

1. Aktive monetare 4,767,892 leke. Ky ze eshte paraqitur ne pasqyre duke u mbeshtetur edhe ne SKK nr 12 *Efektet e ndryshimeve te kurseve te kembimit* dhe paraqet tepricen e llogarise Arka dhe tepricen e llogarise banke, ne monedhen lek dhe euro ne date 31.12.2021. Kursi i kembimit eshte perdorur ne menyre sistematike gjate gjithë ushtrimit te aktivitetit te subjektit per ngjarjet e trasaksionet te cilat jane kryer ne monedha te huaja.

2. Te drejta te arketueshme te cilat jane paraqitur ne vleren **4,189,711 leke** dhe eshte e perbere nga;

Zeri, Nga aktiviteti i shfrytëzimit ne vleren **4,189,711 leke**, i cili eshte evidentuar edhe ne perputhje me SKK nr 3 ne te cilen përfshihen të gjitha të drejtat e krijuara gjate periudhes ushtrimore ndaj



klientave për shitjen e mallrave, produkteve dhe shërbimeve me arkëtim të mëvonshëm, të paraqitura me vlerën neto të realizueshme.

3. Inventari i paraqitur në vlerën **16,384,930 leke**, i cili është i përbërë prej;

Zeri Mallra në vlerën **16,384,930 leke** janë njohur dhe vlerësuar në përputhje me SKK nr 4 *Inventaret*. Kostoja e inventarit është vlerësuar me metodën e kostos mesatare të ponderuar.

Mallrat e blera gjatë periudhës ushtrimore janë **125,394,477 leke** dhe kosto e mallrave të shitur e cila është pasqyruar në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve është **124,154,772 leke**.

✦ Informacione shpjeguese të **AKTIVET AFATGJATA**

Aktivët afatgjatë janë paraqitur në Vlerën Kontabel Neto **7,368,969 leke**. Ato janë evidentuar edhe në përputhje me SKK nr 5 Aktivët afatgjatë materiale dhe aktivët afatgjatë jomateriale. Paraqitja e tyre është bërë nëpërmjet politikës kontabel Metoda e Kostos. Përberja e këtij zeri paraqitet si vijon;

1. Aktive afatgjatë materiale janë në vlerën **7,368,969 leke**. Metoda e përzgjedhur për amortizimin është metoda mbi vlerën e mbetur, dhe është njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën ushtrimore në vlerën **1,913,184 leke**.

Në të janë të përfshirë elementet e mëposhtem;

Nr. Llogarie	Emertimi i Llogarise	Monedha	Debi	Kredi
2181	Makineri dhe pajisje Energjitike	LEK	5,215,754	
2182	Pajisje Kompjuterike dhe Informatike	LEK	1,657,658	
2188	Të tjera	LEK	3,687,180	
281801	Per Makineri dhe Pajisje Energjitike	LEK		1,534,440
281802	Per Pajisje Kompjuterike dhe Informatik	LEK		552,451
281803	Per te tjera	LEK		1,104,732
Totali:			10,560,592	3,191,623

DIFERENCA: 7,368,969

II. Informacione Shpjeguese për **DETYRIMET**.

Detyrimet e paraqitura në pasqyrën e Bilancit janë në vlerën **17,739,664 leke** dhe përbehet vetëm nga detyrime të periudhave afashkurtra. Detajimi jepet nëpërmjet informacioneve shpjeguese si vijon;

✦ Informacione shpjeguese të **DETYRIMEVE AFATSHKURTRA**

Detyrimet afatshkurtra janë paraqitur në total në vlerën **17,739,664 leke**, dhe janë të përbëra nga detyrimet ndaj furnitoreve, punonjesve, detyrime ndaj shtetit për tatime dhe taksa.



- Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit në vlerën **15,754,440 leke** paraqesin detyrimin e papaguar për blerjen e mallrave nga furnitorë të ndryshëm të njesisë ekonomike në fund të vitit 2021.

- Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore në vlerën **168,517 leke** perbejne vetëm detyrimin për pagat e personelit të papaguara deri në fund të vitit 2021 si dhe detyrimin për sigurimet shoqërore dhe shëndetsore për muajin Dhjetor 2021 dhe detajohet si vijon;

Elementi	Ref	Vlera
Sigurime Shoqërore	431	168,517

- Të pagueshme për detyrimet tatimore në vlerën **1,818,707 leke** perbejne detyrimin për muajin Dhjetor 2020 dhe detajohet si vijon;

Elementi	Ref	Vlera
Shteti- TVSh për tu paguar	4453	878,550
Tatim mbi të ardhurat personale	442	35,113
Tatim mbi fitimin	444	882,103
Tatim Qeraje	449	22,941

✦ Informacione shpjeguese të DETYRIMEVE AFATGJATA

Detyrimet afatgjata janë paraqitur në total në vlerën **0 leke**.

III. Informacione Shpjeguese për KAPITALIN

Kapitali i paraqitur në vlerën **14,971,838 leke** dhe është i përbërë nga zërat Kapital i nënshkruar, Fitime të Pashpërndara dhe Fitim / Humbje e vitit, detajimi i të cilave do të jepet në informacionet shpjeguese.

1. Informacione shpjeguese të zërit KAPITAL

Në këtë zë janë paraqitur kapitali i kontribuar nga aksionerët ose nga ortakët dhe janë përmbledhur tëpricat kreditore të llogarive vijuese:

Emertimi	Ref	Vlera
Kapitali fillestar,	101	7,000,000

Në përputhje me aktin e themelimit datë 07/01/2020 kapitali i kontribuar është i përbërë nga kapitali themeltar me vlerë 7,000,000 leke. Kuota ose aksione, gjithsej pjesë, Shoqëria Big Alb Group 1 kuote me vlerë 2,800,000 leke në përqindje 40, Vladimir Lleshaj 1 kuote me vlerë 2,800,000 leke në përqindje 40, Ilir Saliaj me vlerë 1,400,000 leke në përqindje 20.

2. Informacione shpjeguese të zërit FITIME TE PASHPERNDARA



Zeri *Fitime te pashperndara* paraqitet ne vleren **1,545,593 leke** dhe perfshin fitimet që njësia ekonomike ka akumuluar nga periudhat paraardhëse.

3. Informacione shpjeguese te zerit FITIM / HUMBJE E VITIT

Zeri *Fitim / Humbje e vitit* paraqitet ne vleren **6,426,245 leke** dhe paraqitet rezultati i periudhës rrjedhese ushtrimore të njësisë raportuese ashtu si rezulton nga pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve pasi eshte zbritur tatimi mbi fitimin.

❖ Shenime shpjeguese ne lidhje me zerat e paraqitur ne pasqyren TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE.

Pasqyra e te Ardhurave dhe Shpenzimeve eshte paraqitur bazuar ne klasifikimin e shpenzimeve sipas natyres. Ne kete periudhe ushtrimore ka rezultuar nje fitim ne vleren **6,426,245 leke**.

Zeri Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit te paraqitura ne pasqyre evidenton te gjitha shitjet e realizuara me vleren e tyre neto **146,970,171 leke**.

Zeri Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme te paraqitura ne vleren **124,154,772 leke** perfaqesojne koston e mallrave te blera per qellime rishitje. Politika kontabel eshte paraqitur me larte ne zerin *Mallra per shitje* (Inventar).

Zeri Shpenzime të personelit i cili eshte i paraqitur ne vleren **8,102,983 leke** perfaqeson:

1. Shuma *Paga dhe shpërblime* gjate periudhes ushtrimore 01.01-31.12.2021 ne vleren **6,972,924 leke**.
2. Shuma *Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore (paraqitur veçmas nga shpenzimet për pensionet)* gjate periudhes ushtrimore 01.01-31.12.2021 ne vleren **1,130,059 leke**.

Zeri Shpenzime të tjera shfrytëzimi te cilat jane te paraqitura ne vleren **7,102,111 leke** perfaqesojne shpenzimet te cilat jane kryer per zhvillimin e aktivitetit te njesisë ekonomike, dhe perfaqeson zera te shpenzimeve si furnitura, taksa te ndryshme dhe te tjera.

Nga keto:

1-BI.energji.avull.ujë	604	1,549,530 leke
2-Blerje amballazhi	606	737,379 leke
3-Qira	613	1,835,292 leke
4-Publicitet, reklama	624	37,550 leke
5-Shpenzime postare dhe telekomunikacion	626	82,550 leke
6-Sherbime bankare	628	224,926 leke
7-Taksa dhe tarifa vendore	634	137,500 leke
8-Shpenzime te tjera	608/618	300,774 leke



9-Amortizimi	681	1,913,184 leke
10-Shpenzime te pazbritshme gjoba	657	10,817 leke
-Dhurata klienteve	657	272,609 leke

Zeri Shpenzime të tjera financiare te cilat jane te paraqitura ne vleren **0 leke**, perfaqesojne te ardhurat dhe shpenzimet qe vijne nga interesa bankare,interesa kredie, overdrafti si dhe diferenca negative dhe pozitive nga kurset e kembimit.

❖ **Shenime shpjeguese ne lidhje me zerat e paraqitur ne pasqyren CASH FLOW.**

Ne pasqyren e flukseve monetare jane paraqitur flukset hyrese dhe dalese te mjeteve monetare në njësinë ekonomike gjatë periudhës korrente kontabël. Paraqitja është bere sipas metodes indirekte.

Gjate periudhes kontabel ka rezultuar;

Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit ne vleren **799,815 leke**. Fluksi pozitiv ka ardhur pasi flukset dalese te mjeteve monetare per kryerjen e shpenzimeve si psh, paga, detyrime per kontribute te sigurimeve dhe te tatim-taksave jane me te ulta se flukset hyrese te mjeteve monetare gjate ushtrimit normal te aktivitetit nga njesia ekonomike.

Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit ne vleren **-94,150 leke** i cili ka ardhur si rezultat i blerjes se aktiveve afatgjate materiale.

Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit ne vleren **0**

Shenime shpjeguese ne lidhje me zerat e paraqitur ne pasqyren NDRYSHIMEVE TE KAPITALIT .

Ndryshimet ne zerin Kapital kane ardhur si rezultat;

1. Fitim / Humbje e vitit ne vleren **6,426,245 leke**.

Drejtuesi

Eduart Saliaj



Hartuesi

Xhoana Elmazaj

